



Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 nr.350/02-98791/25 dt.09.07.2025, (sipas e-Leja, KKN-00480) në emër të aplikuesve/pronarëve Shpend Mehmeti, Agron Halimi, Albert dhe Labinot Morina, Burbuqe Killokoqi, Granit Beka, Hekri Buzoku, Hasime Qehaja, Nazmi Qehaja, Magbule Shkodra, Bujar Haxhiu, Imer, Afrim, Merita, Gani, Menderes dhe Arben Zogu, me Investitorë “Nord Invest” sh.p.k me seli në Prishtinë, me nr. unik. Identifikues të biznesit 811446443, përmes së cilës kërkohet të përcaktohen kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor-projektin ideor/kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa individuale banimore/shtëpi familjare, gjithsejtë 93 shtëpi banimore, të sistemuara sipas tipeve: Tipi “A” – 11 shtëpi individuale, me etazhitet P+2, Tipi “A”- 46 shtëpi dyshe, me etazhitet P+2, dhe Tipi “A”- 36 shtëpi “Varg”, me etazhitet P+2, si dhe Tipi “A” pesë (5) ndërtesat banesore, me etazhitet P+2, në kuadër të parcelës ndërtimore “A16” dhe “A18”, të bllokut urban “A”, të tërësisë urbane “A”, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Lindore”, në Prishtinë në parcelave kadastrale, nr.1308-2, 1309-3, 1309-5, 1320-0, 1321-0, 1324-0, 1325-0, 1327-0, 1327-0, 1333-1, 1333-2, 1334-1, 1343-0, 1344-3, 1348-3, 1354-3 ZK Matican. Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data 01.08.2025 deri më 15.08.2025, në e-mail adresën: urbanizmpriштine@rks-gov.net dhe ardian.zymeri@rks-gov.net.

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Banim individual
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~ jo më pak se 5m për rrugë me gjerësi deri në 7m’/5.00m’
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	~ 3.00 m’(anësore) ~ 3.00 m’(anësore) ~ 3.00 m’(e pasme)
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	30% e lejuar sipas planit rregullues
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	Max 450 m ² e lejuar sipas planit rregullues
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40% e lejuar sipas Vendimit
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	50% e lejuar sipas planit rregullues
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	Minimum 1-VP për një njësi banimi
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Nënshkrimi i Zyrtarit:

Page 1 prej 1